

2023 FACT SHEET

TERAPITË:



475

Terapi individuale

89

Terapi familjare

47

Terapi grupore

165

Seanca fizioterapeutike

MBËSHTETJA DHE NJOHJA:



53

Të mbijetuarve iu njoh statusi përmes mbështetjes së QKRMT-së

66

Raste të reja të identifikuara të dhunës seksuale nga koha e luftës

SHËNDETI MENDOR DHE MBËSHTETJA PSIKOSOCIALE:



115

Azilkërkues dhe refugjatë në Kosovë kanë përfituar nga programi i mbështetjes së shëndetit mendor dhe psikosocial.

63

Raste të reja të grave dhe vajzave të riatdhesuara morën shërbime psikologjike, mjekësore dhe ligjore

REFERIMET DHE MBESHTETJA



19

Referime për fuqizim ekonomik të grave dhe vajzave të riatdhesuara dhe refugjate

22

Pako esenciale ushqimore dhe higjienike

1300 +

Raste të dokumentuara të dhunës seksuale gjatë luftës

100 +

Shërbime ligjore për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë

20 +

Vizita monitoruese në vendet e privimit nga liria

20 +

Shkresa avokuese



2023

VITI I TRIUMFIT TË DREJTËSISË

Viti 2023, ishte viti i arritjes së drejtësisë për përfituesit e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT).

Në dy raste të ndryshme gjykatat e Kosovës vendosën që përfituesve të QKRMT-së, t'ju njohin drejtësinë.

E MBIJETUARA E PARË QË TRIUMFOI NË TË GJITHA NIVELET E GJYQËSORIT

Pas betejës gjyqësore tre vjeçare, Gjykata Supreme e Kosovës përfundimisht vërtetoi dënimin ndaj dhunuesit Z.V., të dënuar me 13 vjet burgim për dhunë seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Fillimisht, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte dënuar Z.V. me 10 vjet burgim, ndërsa pas ankesës, Gjykata e Apelit e kishte rritur dënimin në 13 vjet burgim. Mbrojta e të akuzuarit kishte paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe Gjykata Supreme e refuzoi këtë kërkesë dhe përfundimisht e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me të cilin Z.V. ishte dënuar me 13 vjet burgim.

Kjo shënon përfundimin e epilogut të këtij rasti dhe tani kemi të mbijetuarën e parë e cila me këmbëngulësinë e saj dhe mbështetjen e pareshtur të QKRMT-së gjatë gjithë procesit, triumfoi në të gjitha nivelet e gjykatave.

QKRMT vazhdon t'i mbështesë dhe t'i inkurajojë të gjithë të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës që të kërkojnë drejtësi!

Ky rast ka kthyer besimin te të mbijetuarit dhe do të jetë motiv për të gjithë të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës që të vazhdojnë t'i raportojnë rastet e tyre në organet e drejtësisë.

PËR HERË TË PARË KOMPENSOHET VIKTIMA E DHUNIMIT NË BURG

Që nga 2014, QKRMT ka mbështetur viktimën që u dhunua në Burgun e Dubravës, ku përveç shërbimeve rehabilituese, e ka përfaqësuar edhe në proceset e stërzgatura gjyqësore, në kërkim të drejtësisë për atë se çfarë i kishte ndodhur në vitin 2014.

Në shtator 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e viktimës dhe ia njohu të drejtën në kompensim të dëmit për shkak të mosveprimit sipas përgjegjësive ligjore të sigurisë në institucionet korrektuese dhe keqtrajtimin e ndodhur në vitin 2014. Sipas Aktgjykimit të Gjykatës, Ministria e Drejtësisë si përgjegjëse e Shërbimit Korrektues të Kosovës, detyrohet ta kompensojë viktimën për shkak të dhimbjeve shpirtërore, dhimbjeve trupore dhe për shkak të cenimit të dinjitetit dhe nderit.

Menjëherë pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, Ministria e Drejtësisë e kompensoi viktimën, ashtu siç ishte paraparë me Aktgjykim.

Ky është rasti i parë i këtij lloji, ku gjykata i bën përgjegjëse institucionet shtetërore për shkeljet e të drejtave të të burgosurve.

Ky rast do të jetë strategjik dhe referencë për çdo shkelje të të drejtave të personave të privuar nga liria.